

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar, Abdullah Ahmeti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve B.K. dhe B.B., që të dy nga Prizreni, secili veç e veç për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit F.H., nga Prishtina, për shkak të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.82/17, të datës 05.01.2018, në seancën publike të kolegjit të mbajtur më 11.qershor. 2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr.82/17 i datës 05.01.2018 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr.82/17, të datës 05.01.2018, të akuzuarit B.K. e B.B., janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari F.H. për shkak të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së është liruar nga akuza.

Lirimi nga akuza është bërë në mungesë të provave se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale, e në mbështetje të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo i plot i gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale të kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.K.-av.D.M. nga Prizreni, ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B.-av.F.V. nga Prishtina, ka parashtuar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.H.-av.F.L. nga Prishtina, ka parashtuar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit i Kosovës, me shkresën e vet PPA/I.nr.181/18 të datës 24.04.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje, ndërsa përgjigjet në ankesë të mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Kjo Gjykatë në bazë të nenit 394 par.1 të KPPRK-së, duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të Prokurorisë Themelore në Prizren, e duke marrë parasysh edhe përgjigjet në ankesa të mbrojtësve të akuzuarve B.B., B.K. dhe F.H. dhe të mendimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit të Kosovës gjeti se:

-Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren nuk është e bazuar.

Prokuroria Themelore-DKR në Prizren, në ankesën e saj pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 e në lidhje me nenin 370 par.7 të KPP, ngase gjykata nuk ka dhënë fakte vendimtare kur ka nxjerrë aktgjykim lirues për të akuzuarit B.K. (Inspektor i Ndërtimitarisë në Komunën e Prizrenit) dhe B.B. (Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit për Komunën e Prizrenit), për veprat penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPRK dhe për të akuzuarin F.H., për veprën penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, dhe gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta se cilat fakte i konsideron si të pa vërtetuara e sidomos nuk ka vlerësuar në mënyrë të saktë provat kundërtënëse e të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren pretendon se të akuzuarit B.K. e B.B. , në aktvendimin e Drejtorisë së Inspektoratit- të Inspeksionit të Ndërtimitarisë të Komunës së Prizrenit, nr.17-354-62, të dt.14.04.2015, është nënshkruar nga të akuzuarit B.K., e që ka të bëjë me fillimin e ndërtimit pa leje të objektit afarist në hyrje të fshatit Zhur, e në pronën publike, edhe pse ka pasur obligim që të veprojnë sipas aktvendimeve dhe konkluzioneve të nxjerra mbi ekzekutimin e detyrueshëm mbi rrënimin e objektit nuk kanë vepruar sipas dispozitave ligjore. Gjykata aktgjykimin e bazon në provat se ankesa shprehimisht nuk e shtyen ekzekutimin e vendimit, por përkundrazi gjykata lidhur me këtë vendim zyrtar nuk paraqet asnjë arsye të qartë, dhe Prokuroria konsideron se të akuzuarit B.K. dhe B.B., kanë kryer vepra penale për të cilët janë akuzuar. Edhe për të akuzuarin F.H., nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë provat edhe pse është vërtetuar se tani i ndjeri I.S. kur ia ka shitur të akuzuarit F.H. parcelën kadastrale me nr. 3680 në sipërfaqe prej 7 ari në hyrje të fshatit Zhur e ka ditur se është pronë publike për çka edhe kanë hartuar vetëm kontratën private duke mos e zyrtarizuar tek noteri e në të cilën parcelë i akuzuari F.H. ka filluar ndërtimin pa leje të objektit afarist B+p+3.

Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorisë Themelore në Prizren, nuk qëndrojnë ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesë e as shkelje të tjera të cilat kjo

gjykatë i konstaton sipas detyrës zyrtare, e te cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, nuk përmban kundërhënie qoftë me vetveten qoftë me arsyetimin e tij, ne arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura juridike dhe faktike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i merr si të provuara ose të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitës së nenit 370 par.7 të KPPRK-se. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjate shqyrtimit gjyqësor duke i paraqitur lidhur me to përfundimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pra, aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban as shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, të cilat kjo gjykatë i konstaton sipas detyrës zyrtare. Nuk ekzistojnë kurrfarë kundërhëniesh mes dispozitivit dhe arsyetimit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar i ka paraqitur faktet që i ka vërtetuar dhe ka dhënë arsye të qarta logjike dhe bindëse për një vërtetim të këtyre të fakteve të cilat si të drejta i pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, sepse gjykata e shkallës së parë ka vepruar në konform me dispozitën e nenit 370 të KPPRK-së, ka arsyetuar çdo pikë të aktgjykimit, ka përshkruar rezultatin e procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare dhe ka dhënë vlerësimin e duhur lidhur me provat e administruara.

Sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës, me vend ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur të akuzuarit në bazë të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, i ka liruar nga aktakuza dhe atë B.K. dhe B.B., secili veç e veç për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarin F.H., nga Prishtina, për shkak të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së, ngase nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se të akuzuarit e lartcekur ti kenë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Gjykata e shkallës së parë, pasi që i ka analizuar të gjitha provat e administruara ka ardhur në përfundim se nuk ka prova që të vërtetojë që të akuzuarit B.K. ne cilesin e inspektorit të ndertimtaris ne Komunen e Prizrenit dhe B.B. ne cilesin e drejtorit të inspektionit ne Komunen e Prizrenit të kenë kryer secili veç e veç veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPRK-së, dhe i akuzuari F.H. ta ketë kryer veprën penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së, e këtë nga arsyeja se aktet administrative të nxjerra nga organi i inspeksionit në Prizren edhe tani janë në fuqi dhe të njëjtit qëndrojnë pranë ekzekutimit të dhunshëm të rrënimit të ndërtesës së tillë, si konkluzioni, njoftimi për të akuzuarin F.H. mirëpo rrënimi nuk është bërë ende në mënyrë që të mundësohet që F.H. ti shfrytëzoj të drejtat që i ka si palë në procedurën administrative e që organi kompetent administrativ në bazë të ligjit mbi Procedurën Administrative, palës i ka dhënë të drejtën e ankesës përkohësisht ka pezulluar ekzekutimin duke konsideruar se në rast se realizohet rrënimi e procedura të përfundoj në favor të palës në kontest administrativ atëherë të njëjtit do ti shkactohej dëm i madhe dhe objekti nuk mund të kthehet në gjendjen fillestare, andaj pritja e vendosjes përfundimtare është e arsyeshme në pikëpamje të shkaktimit të paarsyeshëm të dëmit pasuror, për këto arsye Gjykata e Apelit konsideron se me vend ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur ka shtyrë ekzekutimin e rrënimit të objektit ngase i akuzuari F.H., ka ushtrua ankesë në konkluzion dhe në njoftimin për rrënimin e objektit në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, të cilit nuk kanë vendosur ende për ankesën e gjithashtu ka hapur edhe konflikt administrativ lidhur me këtë çështje administrative para Gjykatës Themelore në Prishtinë, për të cilën nuk është vendosur ende.

Sa i përket të akuzuarit F.H., gjykata e shkallës së parë me vend ka vepruar kur të njëjtin e ka liruar nga akuzat për shkak të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së pa luajtshme,

nga neni 332 par.1 të KPRK-së, ngase nga provat e administruar është vërtetuar se i njëjti në vitin 2015, nga Iliaz Susuri ka blerë 7 ari tokë në hyrje të fshatit Zhur me parcelën kadastrale 3680 dhe se për të njëjtën të gjithë e kanë ditur se është pronë private e Iliaz Susurit, i cili vazhdimisht e ka shfrytëzuar këtë pronë dhe të njëjtën ia ka shitur Faton Hoxhës për 35.000 €. Pra gjykata e shkallës së parë të akuzuarin F.H. e ka liruar nga akuza ngase i njëjti nuk ka pasur kurrfarë arsye që të blenë pronë publike për 35.000 € ngase i njëjti ka qenë i bindur se shitësi Iliaz Susuri këtë pronë kishte shfrytëzuar kohë të gjatë e para tij edhe babi i tij dhe se për të njëjtën kishte paguar edhe tatimin në pronë si dhe shërbimet e tjera komunale.

Për këto arsye Gjykata e Apelit, gjeti se ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren nuk është e bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë e vërtetoi.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.192/18, më 11.06. 2018

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit

Xhevdet Abazi

Fillim Skoro